



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 85 dt. 27.10.2014

Në mbështetje të nenit 47, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 27.10.2014, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për “Kompleks Turistik” në afërsi të fshatit Tragjas, Vlorë.

KKR nuk ka asnjë sugjerim apo objeksion për projektin e mësipërm, pasi ai nuk zhvillohet në zonë të mbrojtur apo pranë ndonjë objekti monument kulture. KKR rekomandon shqyrtimin e projektit për kompetencë në KKA.

2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI